



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Fushë Kosovë shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

|                          |                               |
|--------------------------|-------------------------------|
| <b>Emri i grupit</b>     | Specialistë të Punëve Sociale |
| <b>Institucioni</b>      | Komuna Fushë Kosovë           |
| <b>Nr. i Referencës</b>  | RN00009035                    |
| <b>Kodi</b>              | RPC0002786                    |
| <b>Data e njoftimit</b>  | 16.05.2022                    |
| <b>Afati për aplikim</b> | 06.06.2022 - 20.06.2022       |

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës.
- Shqyrton aplikacione në kohën e duhur dhe merr vendime në bazë të kriterëve që i përcakton Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale.
- Llogarit saktë ndihmën që duhet t'i ndahet familjes në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj.
- Shqyrton aplikacione në kohën e duhur dhe merr vendime në bazë të kriterëve që i përcakton Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale.
- Përgatit lëndën nga aspekti teknik dhe administrativ për futjen e shënimeve në baze të dhënave.
- Bën verifikimin e të gjithë shfrytëzuesve të ndihmës sociale si dhe përgatit lëndet për komisionin mjekësor.
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti i Psikologjisë, Administratë Publike, Pedagogjisë, Sociologjisë, Juridik, Punës Sociale
- Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.



#### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

#### 5. Pozitat aktualisht të lira

---

| Kodi       | Nr. i Referencës | Titulli i pozitës              | Klasa e pozitës | Koeficienti | Institucioni        | Organizata / Vendi i punës  |
|------------|------------------|--------------------------------|-----------------|-------------|---------------------|---|
| RPC0002493 | RN00008717       | Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1 | Profesional 3   | 6           | Komuna Fushë Kosovë | Drejtoria për Shëndetësi dhe MS / Qendra për Punë Sociale - Komuna Fushë Kosovë |

#### 6. Mënyra e aplikimit

---

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

#### 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Vërtetim që nuk jeni nën hetime nga Gjykata

#### 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Aftësi të komunikoj lirshëm me qytetaret dhe stafin menaxhues dhe atë vartës;
- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të punuar me vet- iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të progameve (Word, Exel, Power Point).

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.  
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.  
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

